



Datë: 24.09.2025
Numër Protokolli: 6364/2025

A.nr.1206/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1206/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesi V.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar*** ankesa më numër A.nr. 1206/2025 e datës 24.06.2025, e parashtruar nga ankuesi V.H.
- II. *Ndryshohet*** Njoftimi i datës 30.05.2025 lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, Renditja Përfundimtare e Kandidateve e datës 29.05.2025 dhe Vendimi i datës 28.04.2024, lidhur me listën e ngushtë, përkitazi me procedurën e pranimi sipas konkursit me nr.ref: RN00016882, për pozitën Auditor i Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, në atë mënyrë që, kandidatja A.E largohet nga Vendimi i datës 28.04.2025, Renditja Përfundimtare e Kandidateve e datës 29.05.2025 si dhe Njoftimi i datës 30.05.2025, ndërsa, pjesa tjetër e këtyre akteve mbetet e pandryshuar.
- III. *Obligohet*** Udhëheqësi/ja e Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatim të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit, si dhe të emëroj kandidatin fitues për konkursin me numër Reference RN00016882, bazuar në rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 29.05.2025 dhe njoftimit të datës 30.05.2025 të ndryshuar si në pikën II të dispozitivit.
- IV.** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes të përkujdeset për zbatimin e vendimit sikurse përcaktohet në pikën II dhe III të dispozitivit.
- V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi V.H (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 24.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit më numër reference RN00016882, për pozitën Auditor i Brendshëm, i shpallur nga Ministria e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Mbrojtjes, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.07.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të LPPA-së administroi këto prova: Ankesën me Nr.Prot 4302/2025 e datës 24.06.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Njoftimin e datës 30.05.2025; Përgjigje në ankesë e datës 15.07.2025; Konkursi RN000168882; Plani i rekrutimit i datës 19.02.2025; Formulari i përshkrimit të punës për pozitën Auditor i Brendshëm; Lista e aplikantëve; Vendimin nr,3/208.2025 të datës 07.04.2025 për themelimin e Komisionet të Pranimit; Akt emërimi i A.G i datës 01.02.2013; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i A.G i datës 07.06.2019; Akt emërimi i S.S i datës 02.11.2012; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i Sh.S i datës 13.06.2019; Akt emërimit të E.Z.C, të datës 17.10.2019; Akt emërimit të A.SH, të datës 04.09.2012; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit të A.SH, i datës 07.06.2019; Akt emërimit të V.F të datës 06.01.2021; Vendimin e datës 28.01.2021; Akt emërimit të F.M të datës 17.10.2019; Akt emërimit të F.D të datës 17.10.2019; Vendimin nr.28.05/2021 i datës 28.01.2021, Akt Emërimit të F.M të aftës 17.10.2019, Akt emërimit të F.D të datës 17.10.2019, Vendimin Ref.DBN-MM-5-3-8-2025, të datës 14.04.2025, E-mail e datës 07.05.2025 nga J.B për Komisionin e Pranimit; Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatëve e datës 21.05.2025; Testi individual i kandidatës A.E; Testi individual i ankuesit, Njoftimin e datës 21.05.2025 lidhur me rezultatet e testit me shkrim; E-mail e datës 27.05.2025 nga S.H për intervistë e datës 27.05.2025; Formulari orarit të intervistës me gojë; Pyetjet e Komisionit për intervistë; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 29.05.2025; Njoftimin për rezultate përfundimtare e datës 30.05.2025; Aplikacionin e ankuesit e datës 24.03.2025; se bashku me dokumentacionin e aplikimit (Diplomë e studimeve themelore e datës 13.08.2012; Referencë nga DPZ AL-PLAST e datës 20.04.2003; Vërtetim për periudhën e punës e datës 14.03.2025; Certifikatë nga CIPFA e datës 01.09.2011; Certifikatë nga CIPFA e datës 27.04.2015; Aplikacioni i A.E i datës 21.03.2025 së bashku me dokumentacionin e aplikimit(Diplomë nga Fakulteti Ekonomik e datës 26.03.2015; Diplomë nga Fakulteti Ekonomik e datës 27.05.2021; Certifikatë nga Ministria e Administratës Publike e datës 02-03.05.2018; Certifikatë nga Ministria e Financave e datës 05.06.2019; Vërtetim nga Ministria e Mbrojtjes e datës 23.11.2021; Kopja e letërnjoftimit Formulari i vlerësimit të kryerjes së punëve i datës 06.12.2019; Formulari i vlerësimit të kryerjes së punëve i datës 26.12.2018; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 30.04.2024); email i datës 22.09.2025 nga KPMSHCK-ja për prova shtesë, emaili i datës 22.09.2025 nga Njësisë e Personelit të MM-së.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Ministria e Mbrojtjes më datë 04.02.2025, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00016882, Grupi Auditor i Brendshëm, pozita e punës Auditor i Brendshëm në Njësinë për Auditimit të Brendshëm, një vend, klasa Profesional 1, me afat aplikimi nga data 01.03.2025 deri më datë 30.03.2025.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar ankuesi duke iu nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit. Rrjedhimisht, sipas listës përfundimtare të kandidatëve kandidatja A.E është renditur si kandidatja e parë më gjithsej 97.2, pikë, ndërsa ankuesi është renditura si kandidat i dytë më gjithsej 93 pikë.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në KPMSHCK duke kundërshtuar procedurën Ref: RN00016882 për pozitën Auditor i Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, më pretendimet së kandidatja e përzgjedhur nuk posedon përvojë profesional pas diplomim lidhur me pozitën e shpallur. Kërkon që Këshilli aprovoj si të bazuar ankesën, të animoj njoftimin lidhur më shpalljen e rezultateve përfundimtare, të kërkoj nga Ministria e Mbrojtjes që të ndryshoj njoftimin e datës 30.05.2025, dhe njoftimin lidhur me fazën e verifikimit paraprak, ashtu që, kandidatja A.E të largohet nga lista e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e verifikimit paraprak të datës 28.04.2025, ti mundësohet ankuesit si kandidat i dytë të shpalljet kandidat fitues për pozitën Auditor i Brendshëm.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00016882, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën e Auditorit të Brendshëm janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Ekonomi (pavarësisht nga specializimi), Juridik, Administratë Publike, Financa Publike; **Kërkesat Specifike:** Certifikatë e Auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose Certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë Inistitucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave.; **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore të çështjes iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që rregullojnë procedurat e pranimit në shërbim civil, më theks të veçantë -**Nenit 9 paragrafi 1:** *[Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik].1.Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përgjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike*

-**Nenit 39** [Procedura e pranimit në Shërbimin Civil]: *1.Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur*

parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përfundimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimit i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.

-Nenit 40” 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë/e, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/e civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/e i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se kriteret e përgjithshme formale për pozitën e shpallur kanë qenë në pajtim me rregulloren në fuqi për klasifikimin e Vendeve të punës në shërbim civil (Rregullorja nr.06/2024) dhe së Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit Nr.3/208.2025, të datës 07.04.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të MM-së, është në përbërjen e përcaktuar më nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa, në ndërlidhje me pretendimin bazë të ankuesit së kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kraterin e përvojës së punës lidhur me pozitën e kontestuar, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e kandidates A.E nga dhe konstatoi së e njëjta posedon Diplomën Nr.4874, të datës 26.03.2015, për përfundimin e studimeve themelore më datë 04.10.2013, në Fakultetin Ekonomik, Universitetit “Hasan Prishtina” Departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitet. Ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës pas diplomimit del se kandidatja A.E ka qenë në marrëdhënie pune në Ministrinë e Mbrojtjes dhe atë nga data 12.12.2014 deri më 29.09.2017, në pozitën e zyrtares në kabinetin e ministrit, ndërsa, nga data 30.10.2017 deri më datë 24.08.2020, sipas marrëveshjes për shërbime të veçanta ka punuar si zyrtare administrative në Departamentin e Auditimit të Brendshëm dhe se posedon edhe certifikatën për auditimit të brendshëm në sektorin publik. Andaj, nisur nga gjendja e fakteve të evidentuara si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin se kandidatja A.E nuk ka përmbushur kriterin e përvojës së punës, sepse përvoja e punës si zyrtare e kabinetit të ministrit dhe zyrtare administrative në Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB) nuk konsiderohet si përvojë profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura. Në arritje të këtij përfundimi, Kolegji ka analizuar formularët e vlerësimit të punës për vitin 2018 dhe 2019, të kandidates së shpallur fituese, ku dhe konstatoi së si detyra të punës lidhur me pozitën zyrtare administrative në NJAB kanë qenë: *siguron mbarëvajtjen e punës në zyrën e Drejtorit të tij/saj;*

Evidenton, klasifikon dhe vendosje në dosje dokumentacionin e zyrës së NJAB; Siguron kompletimin e të gjithë dokumentacionit që hyn dhe del nga zyrja; Cakton takime/kontakte të shefit të Departamentit dhe sektorëve më shefa e departamenteve/divizioneve/sektorëve, më zyrtar të tjerë të MM-së dhe më institucione tjera sipas nevojës; Administron të gjithë korrespondencën që vjen dhe del nga departamenti/sektori përkatës, etj. Pra, mbi bazën e analizimit të këtyre detyrave rrjedhë fakti së kjo pozitë ka të bëjë me detyra administrative dhe mbështetëse, e jo me detyra profesionale e që kanë të bëjnë me fushën e auditimit të brendshëm.

Duke qenë së sipas renditjes përfundimtare të kandidateve të datës 29.05.2025, procedura e kontestuar ka përfunduar me dy kandidatë të suksesshëm, Kolegji ka analizuar edhe dosjen e V.H, në këtë rast ankuesit dhe si pasojë nga analizimi i dokumenteve Kolegji ka gjetur së i njëjti sipas Diplomës më nr. 3015 të datës 13.08.2012, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës. Posedon certifikatën për auditim të brendshëm në sektorin publik si dhe vërtetimin e datës 14.03.2029, të lëshuar nga Njësia e Personelit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, më të cilin vërtetohet së i njëjti nga data 01.11.2002 është i punësuar në Departamentin Qendror Harmonizues në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, pozitë të cilën vazhdon ta ushtroj.

Përmbledhur si me lartë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se kandidati V.N ka përmbushur kriteret formale lidhur me pozitën përkatëse të punës, e duke qenë se i njëjti në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka arritur ti grumbulloj pikët e nevojshme për tu konsideruar si kandidatë i suksesshëm, atëherë, më të drejtë Njësia e Burimeve Njerëzore të organit të punësimit të njëjtin e ka shpallur si kandidat të suksesshëm, ndërsa, Njësia e Burimeve Njerëzore në fazën e verifikimit paraprak nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale duke përfshirë kandidatet A.E në listën e ngushtë, sepse, sic u tha me sipër njëjta nuk ka përmbushur kriterin e përvojës profesionale.

Pas konstatimeve si më sipër, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18, paragrafi 1 ,nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit, ashtu që, anuloj Njoftimin e datës 30.05.2025 lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, Ndryshoj Njoftimin e datës 30.05.2025 lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, Renditjen Përfundimtare të Kandidateve të datës 29.05.2025 si dhe Vendimin e datës 28.04.2024 lidhur me listën e ngushtë, në atë mënyrë që, kandidatja A.E largohet nga Vendimi i datës 28.04.2025, Renditja Përfundimtare e Kandidateve e datës 29.05.2025 si dhe Njoftimi i datës 30.05.2025, ndërsa, pjesa tjetër e këtyre akteve mbetet e pandryshuar. Obligohet Udhëheqësi/ja e Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatim të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit, si dhe të emëroj kandidatin fitues për konkursin me numër Reference RN00016882, bazuar në rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 29.05.2025 dhe njoftimit të datës 30.05.205 të ndryshuar si në pikën II të dispozitivit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1206/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.H;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Arkivit të KPMSHCK-së